

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë, sot në datën 23.12.2020 (dymijë e njëzetë), lidhet kjo kontratë dhurimi kuotash mes:

DHURUESI: **Arben Arapi**, i biri i Rexhepit dhe i Hatixhes, i datëlindjes 09.11.1972, lindur në Klos dhe banues në Tiranë, mbajtës i leternjoftimit me nr. **034346572** dhe nr. personal **H21109078L**, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cilizotëron 1 pjesë në shoqëri me vlerë 20.330.800,00 (njëzetë milion e treqind e tridhjetë mijë e tetëqind) Lekë, të llojit në kontribut “në para”, me pjesëmarrje në përqindje në masën 40 % të kapital të rregjistruar;

PRANUESI I DHURIMIT: **Azbi Arapi**, i biri i Rexhepit dhe i Hatixhes, i datëlindjes 13.10.1970, lindur në Klos dhe banues në Tiranë, mbajtës i leternjoftimit me nr. **034186423** dhe nr. Personal **H01013069E**, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Palët e mësipërme, pasi ranë dakord nëpërmjet vullnetit të tyre të lirë dhe pëlqimit reciprok, bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përpiluan këtë kontratë dhurimi kuotash:

Duke qënë se:

- a) Shoqëria “**A&A SECURITY SURVEY**” sh.p.k., ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në QKB me NUIS K31915018E, me seli në adresën rruga “Lord Bajron”, Vila 1, Laprakë, Tiranë;
- b) Shoqëria “**A&A SECURITY SURVEY**” sh.p.k., ka kapital themeltar të regjistruar prej 50.827.000,00 Lekë;
- c) Dhuruesi **Arben Arapi**, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotëron 1 pjesë të kapitalit me pjesëmarrje në përqindje në masën 40% të vlerës totale të kuotave të kapitalit, prej 20.330.800,00 (njëzetë milion e treqind e tridhjetë mijë e tetëqind) Lekë, të llojit kontribut “në para”.

Njëkohësisht, dhuruesi dhe pranuesi kanë rënë dakord që të lidhin këtë kontratë dhurimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i Kontratës



Kjo kontratë ka për objekt dhurimin e 1 pjese të kapitalit të rregjistruar me vlerë prej 10.165.400,00 (dhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind) Lekë, të llojit në kontribut "në para", e cila përbën pjesëmarrje në vlerën 20% të kapitalit të shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k.dhe kalimin e pronësisë së kuotës nga dhuruesi tek pranuesi i dhurimit.

Neni 2 Baza Ligjore

Kjo kontratë hartohet në bazë dhe për zbatim të:

1. Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti të nenit 761 e vijues të tij;
2. Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" datë 14.04.2008 i ndryshuar me ligjin Nr.129/2014, pjesën IV të tij në veçanti neni 73 e vijues të tij, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
3. Statutit të shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k.;
4. Vendimit Nr. 70, datë 21.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k.

Neni 3 Transferimi i Pronësisë mbi Kuotat

1. Pronësia mbi kuotën do të transferohet menjëherë nga dhuruesi tek pranuesi i dhurimit, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Me nënshkrimin e kontratës së dhurimit, dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë apo detyrim mbi kuotën e shoqërisë si dhe çdo lloj detyrimi tjetër që shoqëria mund të ketë ndaj të tretëve dhe që mund të pretendohet për shkak të cilësisë së ortakut, përfshirë këtu të gjithë aktivet dhe pasivet e shoqërisë.
3. Të gjithë të drejtat që dhuruesi zotëronte do t'i kalojnë pranuesit të dhurimit, duke përfshirë të drejtën për të përfituar dividendin e pashpërndarë. E drejta për të përfituar dividendin e pashpërndarë përfshin dividendin e të gjithë vitit financiar të nënshkrimit të kontratës dhe ato të viteve financiare të mëparshme, për sa kohë nuk janë shpërndarë ende në nënshkrimin e kësaj kontrate.
4. Dhuruesi mbetet përgjegjës për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, të lindura përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, pavarësisht nëse këto detyrime bëhen të kërkueshme nga të tretët apo kreditorë të ndryshëm pas datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4 Efektet e Kontratës



1. Kalimi i pronësisë së kuotës nga pala dhuruese tek pala pranuese, në përputhje me përcaktimet e kësaj kontratedhe në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" – i ndryshuar, do të regjistrohet pranë Q.K.B-së.
2. Regjistrimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ka efekt deklarativ.
3. Ngarkohet **administratori i shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k., Z. Gazmir Arapi**, për të ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme për ekzekutimin dhe depozitimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Dokumentat e Bashkëlidhura

Kësaj kontrate i bashkëlidhen dhe konsiderohen pjesë e pandashme e saj dokumentet si më poshtë e vijon:

1. Vendimi i Asamblesë së Përgjithme të Shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k.;
2. Dokumentet identifikuese të palëve;
3. Ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "A&A SECURITY SURVEY".

Neni 6

Dispozita e Fundit

1. Pala dhuruese garanton palën pranuese të dhurimit se kuota që transferon nëpërmjet kësaj kontrate është e lirë nga çdo barrë apo detyrim karshi të tretëve. Për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët e që cënon të drejtën e pronësisë së palës pranuese të dhurimit, dhuruesi është i detyruar të paraqitet menjëherë me kërkesën e palës pranuese të dhurimit dhe të çdo personi tjetër të tretë, që pretendon mbi këto kuota, pranë gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e pronësisë së kuotës pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, pranuesi i dhurimit **Azbi Arapi**, bëhet pronar i **1 kuote të barazvlefshme me vlerë prej 10.165.400,00 (dhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind) Lekë, të llojit në kontribut "në para", e cila përbën 20% të kapitalit të shoqërisë "A&A SECURITY SURVEY" sh.p.k.**
3. Kontrata mbi kërkesën e palëve u hartua në 4 kopje autentike, në katër faqe me të njëjtën fuqi ligjore, një kopje e kontratës i jepet palës dhuruese, një kopje për pranuesin e dhurimit, një kopje për depozitim në Q.K.B. së bashku me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe një kopje për shoqërinë.
4. Palët, pasi kanë lexuar dhe pranojnë së kjo kontratë dhurimi është në pajtim të plotë me vullnetin e tyre, e nënshkruajnë atë rregullisht.



PALËT KONTRAKTUESE:

DHURUESI

Z. Arben Arapi

Arben Arapi


PRANUES I DHURIMIT

Z. Azbi Arapi

AZBI ARAPI
